



## Eficienca e buxhetit të Bashkisë Kolonjë (Viti 2020)

### 1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

**Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve**

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
<b>Transferta e pakushtëzuar</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	120,195	1,166,942	35 %
<b>Transferta e kushtëzuar</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	96,002	932,058	28 %
<b>Transferta e pakushtëzuar sektoriale</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	4,334	42,078	1 %
<b>Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore</b> (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	80,050	777,184	23 %
<b>FZHR</b> (Grante nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve)	45,348	440,267	13 %
<b>TOTALI</b>	<b>345,929</b>	<b>3,358,529</b>	<b>100 %</b>

Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

**Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Kolonjë 2020**



Burimi: Bashkia Kolonjë, llogaritje EIC

## 2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Kolonjë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

**Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale**

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	189,446	1,839,282	55
Shpenzime Korrente	92,737	900,359	27
Shpenzime për Investime	63,746	618,888	18
<b>TOTAL</b>	<b>345,929</b>	<b>3,358,529</b>	<b>100 %</b>


Burimi: Bashkia Kolonjë, llogaritje EIC

**Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale**



Burimi: Bashkia Kolonjë, llogaritje EIC

**Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale**



Burimi: Bashkia Kolonjë, llogaritje EIC